



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 247/2 Prot.

Tiranë, më 16.02. 2026

VENDIM
Nr. 15, datë 16.02.2026

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT 54, DATË 21.11.2025

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr.54, datë 21.11.2025, të Komisionerit, "Mbi përfundimin e procesit të inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procesit të ndjekur për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, në institucionin e Bashkisë Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë",

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 58, (nr.641 prot.,) datë 26.6.2025, "Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procesit të ndjekur për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, në institucionin e Bashkisë Kukës", Komisioneri ka filluar kryesisht verifikimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me procedurën e hartimit dhe miratimit të akteve të përshkrimit të punës, për pozicionet e shërbimit civil, në Bashkinë Kukës.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 54, datë 21.11.2025, të Komisionerit, "Mbi përfundimin e procesit të inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procesit të ndjekur për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, në institucionin e

shërbimit civil gjatë procesit të ndjekur për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, në institucionin e Bashkisë Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë”, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 54, datë 21.11.2025, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse dhe komunikimit elektronik (*me e-mail*), vërej se situata e administrimit të shërbimit civil në institucion paraqitet si më poshtë vijon:

1. Lidhur me zbatimin e pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit

Në pikat 2, 3 dhe 4 të vendimit paralajmërues është kërkuar:

- përfundimi i procesit të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, në përputhje me VKM nr. 142, datë 12.3.2014, të ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 1, datë 31.5.2017 të DAP-it, si dhe orientimet e dhëna nga Komisioneri;
- Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me aktorët e tjerë të procesit, të evidentojë nëpunësit që nuk kanë hartuar përshkrimet e punës për 58 pozicione të shërbimit civil dhe të përfundojë hartimin e tyre, duke vijuar me miratimin nga Sekretari i Përgjithshëm dhe nënshkrimin nga eprori direkt dhe nëpunësi, sipas procedurave ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se institucioni i Bashkisë Kukës ka përmbushur pikat e mësipërme të vendimit të Komisionerit. Konkretisht:

- Procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil është përfunduar në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
- Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me aktorët përkatës, ka evidentuar rastet e mungesës së përshkrimeve të punës dhe ka përfunduar hartimin e tyre për të 58 pozicionet e konstatuara.
- Formularët përkatës janë miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe janë nënshkruar nga eprori direkt dhe nëpunësi civil, duke respektuar kërkesat procedurale dhe standardet e administrimit të shërbimit civil.

2. Lidhur me zbatimin e pikës 5 të Vendimit

Në pikën 5 të vendimit, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që një kopje e përshkrimeve të punës, e nënshkruar nga të gjithë aktorët e procesit, të përfshihet në dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, ndërsa një kopje tjetër të depozitohet pranë zyrës së Arkivës së institucionit, për administrim dhe ruajtje sipas rregullave në fuqi.

Nga informacioni i përcjellë me shkresën nr. 298 prot., datë 30.01.2026, vërej se:

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-Hotel Drini, Tiranë, Tel: 00355 4268141, Web: www.kmshc.al E-mail: info@kmshc.al

përshkrimet e punës janë përfshirë në dosjet individuale të personelit të çdo nëpunësi civil;
kopjet përkatëse janë depozituar pranë zyrës së Arkivës së institucionit, në përputhje me rregullat e administrimit dhe ruajtjes së dokumentacionit zyrtar.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar dhe verifikimi i masave të ndërmarra nga Bashkia Kukës, çmoj se janë përmbushur detyrimet e përcaktuara në Vendimin Paralajmëruar nr. 54, datë 21.11.2025, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke rivendosur ligjshmërinë në procesin e hartimit, miratimit dhe administrimit të formularëve të përshkrimit të punës për pozicionet pjesë e shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.54, datë 10.11.2025, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procesit të ndjekur për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, në institucionin e Bashkisë Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë”.
2. Konstatimin e rregullimit të situatës së ligjshmërisë nga ana e Bashkisë Kukës, në përputhje me detyrimet e Vendimit nr.54, datë 10.11.2025, të Komisionerit.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Kuçovë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

